

20131373301

L I G J
PËR PLOTESIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË TRASHEGIMISE
KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të trashëgimise kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11 dhe 23/13), në nenin 10 pas paragrafit (4) shtohen tre paragrafe të rinj (5), (6) dhe (7), si vijojne:

„(5) Republika e Maqedonise mund ta marre të drejten e pronësise së trashëgimise kulturore të tundshme dhe të patundshme me anë të trashëgimit.

(6) Nese në aktin për trashëgim të trashëgimise kulturore të tundshme dhe të patundshme permbahet kushti që Republika e Maqedonise ta marre të drejten e pronësise së trashëgimise kulturore të tundshme dhe të patundshme, Qeveria e Republikës së Maqedonise me propozim të Ministrise së Kultures dhe Ministrise së Financave, miraton vendim për pranim, perkatesisht mospranim të kushtit nga akti për trashëgim, varesisht nga rendesia dhe vlera e trashëgimise kulturore të tundshme dhe të patundshme që eshte lende e trashëgimit dhe vlera e kushtit nga akti për trashëgim.

(7) Percaktimin e rendesise dhe vleres së trashëgimise kulturore të tundshme dhe të patundshme e kryen Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimise Kulturore, ndersa të vleres së kushtit nga akti për trashëgim e kryen Byroja për Ekspertiza Gjyqesore.“

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".